

RAPORT AUDITIMI FINANCIAR

**MBI AUDITIMIN E FONDEVE TE PERDORURA NGA
PARTIA E PAJTIMIT KOMBETAR DHE 6 KANDIDATE TE
MBESHTETUR NGA ZGJEDHESIT , NE FUSHATEN PER
ZGJEDHJET PER ORGANET E QEVERISJES VENDORE TE
DATES 08.05.2011**

POROSITESI

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE TIRANE

AUDITOI :

PAJTIM HYSI
Ekspert kontabel i autorizuar, Nr licence 63

Periudha e mbuluar

Prill deri 7 Maj 2011

Data e mbylljes

15.01.2011

Une kam kryer auditimin ligjor te fondeve te perftuara dhe te shpenzuara nga Partia Pajtimi Kombetar dhe 6 kandidateve te mbeshetur nga zgjedhesit per fushaten elektorale per zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 8 maj 2011, dhe konkretisht z. Zef Mark Simoni, z. Kol Zef Zefi, z Hysen Safet Llaca, z. Vladimir Illo Kumi, z. Çup Nikoll Boçi, z. Fehmi Mehdi Cengu.

Ky auditim eshte kryer ne zbatim te kontrates se sherbimit te lidhur me date 18.11.2011 me objekt : ‘kryerjen e auditimit ligjor te detyrueshem te fondeve te perftuara dhe te shpenzuara nga Partia Pajtimi Kombetar dhe 6 kandidateve te mbeshetur nga zgjedhesit per fushaten zgjedhore,ne perputhje me ligjin Nr 10019 date 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise”, ligjin Nr 10091 date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe kontabilistit te miratuar”, dhe ligjit Nr 9228 date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe pasqyrat Financiare” si dhe aktet nenligjore te nxjera ne baze dhe per zbatimin e tyre.

Vendi i kryerjes se ketij auditimi, sipas percaktimit ne kontrate ishin ambientet e subjekteve zgjedhore. kurse perpunimi i dokumentacionit dhe perpilimi i raportit u be ne studion tone ne Fier.

Objekti i ketij auditimi eshte dhenia e nje opinionit per shkallen e zbatimit te kerkesave te percaktuara ne ligjin Nr 10019 date 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise”, ligjin Nr 10091 date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe kontabilistit te miratuar”, dhe ligjit Nr 9228 date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe pasqyrat Financiare” si dhe aktet nenligjore te nxjera ne baze dhe per zbatimin e tyre, mbeshetur mbi nje kontroll fizik me zgjedhje te dokumentave qe disponon subjekti zgjedhor.

Auditimi u krye ne periudhen 01.12.2011 deri ne 14.01.2012 dhe perfshiu kontrollin e arketimeve dhe shpenzimeve te kryera nga Partia Pajtimi Kombetar dhe 6 kandidateve te mbeshetur nga zgjedhesit, per fushaten elektorale per zgjedhjet per organet e qeverisjes vendore te dates 8 maj 2011.

Konstatime te procedures se auditimit

Asnje nga subjektet e siperpermendur nuk nuk ploteson kushtet sipas nenit 87 te ligjit Nr 10019 date 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise” per te perfituar fonde publike.

1 - Partia Pajtimi Kombetar

Nuk ka fonde te arketuara per fushaten zgjedhore, e po keshtu nuk ka as shpenzime te dokumentuara.

Edhe ne raport me nenin 88 te ligjit Nr 10019 date 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise”(Ndalimi i perdorimit te burimerve publike ne mbeshetje te subjekteve zgjedhore) nuk ka financime ose perdorime te dokumentuara.

2 – Z. Zef Mark Simoni është kandidat i mbështetur nga zgjedhësit për zgjedhjet e për Keshillin e Bashkisë Rreshen, qarku Lezhë.

Ka çelur regjistrin për të evidentuar fondet e përfituara.

Nuk ka fonde të arketuara për fushatën zgjedhore, e po kështu nuk ka as shpenzime të dokumentuara.

3 - Z. Kol Zef Zefi është kandidat i mbështetur nga zgjedhësit për zgjedhjet për Keshillin e Komunes Gur i Zi Qarku Shkoder.

Ka çelur regjistrin për të evidentuar fondet e përfituara.

Nuk ka të regjistruara fonde të arketuara për fushatën zgjedhore, e po kështu nuk ka as shpenzime të dokumentuara.

4 - Z. Hysen Safet Llaca është kandidat i mbështetur nga zgjedhësit për zgjedhjet për Kruetarin e Bashkisë Sukth, Qarku Durrës.

Ka çelur regjistrin për të evidentuar fondet e përfituara.

Nuk ka në evidence fonde të arketuara për fushatën zgjedhore, nga ndonjë subjekt ose person, e po kështu nuk ka as shpenzime të dokumentuara.

5 - Z. Vladimir Illo Kumi është kandidat i mbështetur nga zgjedhësit për zgjedhjet për Kryetarin e Komunes Lukovë, Qarku Vlorë.

Ka çelur regjistrin për të evidentuar fondet e përfituara.

Ka fonde të arketuara për fushatën zgjedhore në masën 50 000 leke, të dokumentuara sipas kërkesave të ligjit. Në të njëjten masë janë edhe shpenzimet të dokumentuara.

6 - Z. Çup Nikoll Boci është kandidat i mbështetur nga zgjedhësit për zgjedhjet për Keshillin e Bashkisë Fan, Qarku Lezhë.

Ka çelur regjistrin për të evidentuar fondet e përfituara.

Nuk ka fonde të arketuara për fushatën zgjedhore, e po kështu nuk ka as shpenzime të dokumentuara.

7 - Z. Fehmi Medi Cengu është kandidat i mbështetur nga zgjedhësit për zgjedhjet për Keshillin e Bashkisë Kukës, Qarku Kukës.

Ka çelur regjistrin për të evidentuar fondet e përfituara.

Nuk ka regjistrim të fondeve të arketuara për fushatën zgjedhore. Shpenzimet për fushatën i ka të kufizuara në masën e mundësive personale.

Në përgjithësi u vërejt se subjektet zgjedhore të sipërpermendura kishin vëmendje minimale për dokumentimin e administrimit të fondeve për fushatën elektorale, duke e konsideruar përgjithësisht këto në më të shumtën e rasteve si problem personal.

Opinionin ynë në përfundim të kontrolleve që i gjykojmë të mjaftueshme për arritjen e tij është se :

Subjektet zgjedhore Partia Pajtimi Kombëtar dhe 6 kandidatët e mbështetur nga zgjedhësit për fushatën elektorale për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 8 maj 2011, dhe konkretisht z. Zef Mark Simoni, z. Kol Zef Zefi, z. Hysen Safet Llaca, z. Vladimir Illo Kumi, z. Çup Nikoll Boçi, z. Fehmi Mehdi Cengu, kanë respektuar

kerkesat e ligjit Nr 10019 date 29.12.2008 “Kodi zgjedhor i Republikes se Shqiperise”, per kreun II, nenet 87,88,89dhe 90 te tij. Dokumentimi dhe veprimet e kryera prej tyre (megjithese jane minimale per nga numri), jane ne perputhje me kerkesat e Ligjit Nr 9228 date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe pasqyrat Financiare” si dhe aktet nenligjore te nxjera ne baze dhe per zbatimin e tyre.

Ekspert Kontabel i Autorizuar
Nr i licenses 63
Pajtim Hysaj

Fier, me 14.01.2012